

Në bazë të pikës 5.7.3. të Programit të aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe të natyrës në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2019 (“Lajmëtari zyrtarë i Qytetit të Shkupi” nr. 18/18), Sektori për mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe të natyrës shpall:

**Thirrje publike
për tubimin e kërkesave
për shfrytëzim të mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019,
të përcaktuar për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe
fondacioneve**

Përcaktimi i mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019, nga Programi RA, nën-zëri 482920, do të realizohet në përputhje me Kodeksin e praktikave pozitive për përkrahjen financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve (“Gazeta zyrtare e RM”, nr. 130/07), dhe në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit nga fusha e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe natyrës në territorin e Qyteti të Shkupit për vitin 2019 dhe në bazë të kriterëve dhe prioritetëve të dhëna në këtë thirrje publike.

1. Përshkrim i shkurtër:

Mjetet nga buxheti i Qytetit të Shkupit do të shfrytëzohen për financimin e projektit me të cilin do të realizohet aktiviteti programor i Qytetit të Shkupit për **“Zhvillimin e kopshtit të parë urban në qytetin e Shkupit”**, që nënkupton zbatimin e kopshtarisë permakulturore për ndërtimin e kopshtit në harmoni me natyrë.

Permakultura është degë e inxhinierisë ekologjike, e cila bazohet në bujqësinë e qëndrueshme dhe ekologjinë. Ajo paraqet një interaksion të harmonizimit në mes njerëzve dhe peizazheve përmes shfrytëzimit të resurseve lokale që janë në disponim, por jo në mënyrë invazive dhe eksploatuese, por përmes mbylljes së qarkut në suaza të natyrës përmes reproduktimit dhe ri - distribuimit të tepicës. Ky term gjithashtu nënkupton edhe përfshirjen e segmentit social dhe krijimit të bashkësisë, përkatësisht rrjetit të individëve dhe grupeve që përhapin zgjidhjet dhe parimet e permakulturës. Nga qasja permakulturore drejtë bujqësisë, më vonë është zhvilluar një lëvizje e tërësishme filozofike që udhëzon drejtë shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe të jetës në pajtim me natyrën.

Në fakt, permakultura është qasje kreative e cila bazohet në:

- Idetë për ndërtim të jetës dhe punës, në mënyrë që të frymëzohen nga funksionimi i natyrës, e cila paraqet sistemin më të përsosur dhe më të komplikuar;
- Idetë për bashkëpunim me natyrën;
- Qasja humane ndaj të tjerëve dhe Kujdesi për gjeneratat e ardhme.

Shoqatat civile dhe fondacionet të cilët marrin pjesë në këtë thirrje janë të obliguar që:

- Të propozojnë lokalitetin për kopshtin urban në suaza të sipërfaqes së gjelbërimit publik, përkatës për realizimin e projektit dhe me madhësinë përkatëse;
- Të parashikojnë vëllimin dhe llojin e aktiviteteve, përkatësisht ta kuptimësojnë projektin;
- Të theksojnë sipas cilave parime të permakulturës do të realizohet projekti;
- Të sigurojnë pjesëmarrjen aktive në implementimin e vetë qëndrimit të kopshtit gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe të sqarojnë se në cilën mënyrë sigurohet qëndrueshmëria e mëtutjeshme;
- Të parashikojnë aktivitetet për edukimin, në veçanti për zhvillimin e permakulturës,
- Ti sqarojnë të gjitha benefitet nga realizimi i projektit.

2. Mjetet e përgjithshme të parashikuara

Për financimin e aktiviteteve programore të ofruara, në përputhje me thirrjen publike, do të shfrytëzohen mjetet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019, me shumë të përgjithshme 2.000.000,00 denarë.

3. Korniza kohore

Afati përfundimtar për realizimin e projektit është 14 muaj nga nënshkrimi i kontratës për bashkëpunim. Shfrytëzimi i mjeteve do të specifikohet në kontratën ndërmjet shoqatës civile / fondacionit dhe Qytetit të Shkupit.

4. Kriteret themelore organizative

Kriteret themelore organizative të cilat duhet t'i plotësojnë shoqatat civile dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqata civile dhe fondacione me seli në Shkup;
- Të merren me aktivitete dhe projekte të interesit publik;

- Të mos kenë fituar mjete ose të mos kenë parashtuar fletëparaqitje nga/deri te organe të administratës shtetërore ose burime të jera për të njëjtin qëllim dhe aktivitet për të cilin parashtrojnë fletëparaqitje, që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të të njëjtave aktivitete nga burime të ndryshme.

5. Kriteret e posaçme

Kriteret e posaçme të cilët duhet ti plotësojnë shoqatat civile dhe fondacionet që marrin pjesë në këtë thirrje, për shkak të specifikave të projektit janë:

- të kenë përvojë nga fusha e permakulturës;
- të kenë realizuar së paku 1 park të permakulturës me interes publik;
- të kenë realizuar së paku 1 park të permakulturës ku kemi ndikime shoqërore, sociale dhe arsimore;
- të disponojnë me së paku 3 dizajnerë të permakulturës (dëshmia: Certifikata për dizajner të permakulturës);
- të disponojnë me së paku 1 dizajner të permakulturës me diplomë (dëshmia: Diploma për dizajner të permakulturës);
- të disponojnë me së paku 2 dizajner të permakulturës me certifikate për trajnime të kaluara për metodologjinë edukative, për trajnim të trajnuesve për permakulturë,
- të njëjtit të posedojnë përvojë ndërkombëtare në aktivitetet lidhur me dizajnin e permakulturës;
- të njëjtit të kenë qenë pjesëmarrës në konvergjenat e permakulturës në nivel ndërkombëtarë;
- të posedojnë me së paku 1 inxhinier të diplomuar të bujqësisë, specialist për agrikulturë;
- të posedojnë me së paku 1 inxhinier të diplomuar arkitekt, specialist për zhvillimin e qëndrueshëm urban;
- të disponojnë me së paku 1 bujk të regjistruar si bujk individual.

6. Vlerësimi i cilësisë së projekteve

Vlerësimin e projekteve të dorëzuara nga shoqatat civile dhe nga fondacionet, të cilët do ti përmbushin kriteret themelore organizative dhe kushtet e posaçme, do ta kryej Komisioni i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të kriterëve vijuese:

Kriteret për vlerësim	Pikat maksimale
1. Struktura organizative dhe resurset	40
1.1. Kapaciteti i shoqatës / fondacioneve krahas resurseve njerëzore për realizimin e projektit (të punësuarit, vullnetarët aktiv, personat e angazhuar me honorarë, profesionaliteti i personave të cilët e realizojnë projektin).	10
1.2. Përvoja e shoqatës / fondacionit për realizimin e projekteve të vëllimit të tillë të aktiviteteve në fushën përkatëse.	10
1.3. Furnizimi hapësinorë dhe teknik i shoqërisë / fondacionit për realizimin e projektit.	10
1.3. Aftësia për menaxhim me buxhetin (vallë buxheti vjetor i shoqatës / fondacionit për vitin e fundit të kalendarit e tejkalon lartësinë e grandit).	10
2. Bashkë financimi i projektit	10
2.1. Vallë shoqata ose fondacioni siguron përqindjen e pjesëmarrjes pronësore në realizimin e projektit .	10
3. Cilësia e projektit	50
3.1. Zgjidhje të ofruara cilësore dhe inovative për realizimin e detyrës projektuese.	10
3.2. Aktivitete programore të përpiluara në mënyrë të detajuar.	10
3.3. Vallë plani për realizimin e projektit është i qartë dhe i realizueshëm.	10
3.4. Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave tjera, relevante për projektin dhe për aktivitetet e parapara.	10
3.5. Vlerësimi i arsyeshmërisë së shpenzimeve lidhur me planin e propozuar financiarë (buxhet real krahas aktiviteteve dhe numrit të personave të angazhuar, përshkrimi i shpenzimeve sipas pozitës dhe sa të njëjtit përputhen me çmimet e tregut).	10
Numri maksimal i pikave	100

Çdo sferë e kriterëve të posaçme programore do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pika ose 10 pika, me kuptimin vijues: 1 – jo, 5 – pjesërisht dhe 10 – po.

7. Dokumentacioni i detyrueshëm për aplikim

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në thirrjen publike duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitjen e plotësuar kompjuterike për përkrahjen financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve, të nënshkruara nga përfaqësuesi i shoqatës civile ose fondacionit të vërtetuar me vulë të shoqatës civile ose fondacionit;
- Formular i plotësuar kompjuterik për *propozim – projektin*;

- Statutin e shoqatës civile ose fondacionit;
- Fotokopje nga aktvendimi për regjistrimin e shoqatës civile ose fondacionit;
- Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar kalendarik dhe mënyrën e realizimit të tyre (nëse organizata ka qenë përfitues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018);
- Raport vjetor i shoqatës civile ose fondacionit për vitin paraprak;
- Fotokopje nga llogaria përfundimtare për vitin paraprak;
- Vërtetim për pagimin e tatimeve të lëshuar nga organet tatimore.

8. Dokumentacioni përcjellës

Shoqatat civile dhe fondacionet si shtojca duhet të dorëzojnë edhe këto dokumentacione përcjellëse:

- Biografi profesionale të profesionistëve të cilët do të angazhohen në realizimin e projektit;
- Listën referente ose dëshminë (për shembull: kontrata e nënshkruar) për së paku 2 projekte të realizuara nga fusha në të cilën aplikohet kopshti publik, në pajtim me alinenë 2 dhe 3 të pikës 5 të kësaj thirrjeje;
- Së paku 2 mendime (referenca) nga partnerët ose donatorët për realizimin e projekteve të mëparshme;
- Përkrahje me shkrim nga organizatat tjera dhe / ose institucionet për të cilët është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.

Shoqatat civile dhe fondacionet mund të parashtrojnë vetëm një fletëparaqitje për përkrahje financiare për një projekt ose manifestim.

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacionet e paplota ose ato që do të dorëzohen pas afatit të paraparë, nuk do të shqyrtohen!

Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.

9. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është 15 ditë nga shpallja e thirrjes në ueb faqen e Qytetit të Shkupit.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e tërësishëm të dorëzohen në zarf të mbyllur me shenjën: **Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës – Fletëparaqitje për thirrjen publike për OJQ për vitin 2019.**

Zarfi dorëzohet përmes postës në adresën vijuese:

Qyteti i Shkupit,

Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës,

bul. "Ilindenska" 82

1000 Shkup,

ose në arkivin e Qytetit të Shkupit nga ora 08.30 deri më 15.00.

Shoqatat civile ose fondacionet pjesëmarrëse në thirrjen publike do të informohen për rezultatet në afat prej 7 ditëve nga dita e sjelljes së Vendimit për përcaktimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019 të destinuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe fondacioneve dhe në Sektorin për mbrojtjen e mjedisit jetësorë, baraka 14.

Fletëparaqitja për përkrahje financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve, si dhe Formulari për Propozim – projektin mund të merren në ueb-faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Pyetje për sqarime plotësuese mund të parashtrihen në formë të shkruar ose nëpërmjet formës elektronike deri te Sektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës në adresën: infoekologija@skopje.gov.mk.

Kontakti: Sektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës, tel: 02/ 3297 273.